



## KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 626-23-5049-2-2-1/C140

**KOMUNA E MAMUSHËS** të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

**Operatori Ekonomik:** "GJEOPROJEKT" SH.P.K me nr. të biznesit: 810734451 me seli në Rahovec të cilin e përfaqëson z. Suad Çmega, në cilësinë e Drejtorit (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

"Shërbime për matjet kadastrale në Mamushë"-Ritender me numër identifikues të prokurimit: 626-23-5049-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-002-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Matjet e ndryshme kadastrale të pronave, ndërtesave dhe objekteve tjera në Mamushë për shërbimet e më poshtme:

| PARAMASA DHE PARALLOGARIA PER MATJE KADASTRALE |  |         |       |
|--|--|---------|-------|
| Nr   | Përshkrimi   | Njësia  | Sasia |
| I  | <b>Përkufizimi i parcelave - Poentim 35 pikë</b>                                     |         |       |
| 1.1  | Parcela deri 0.50 ha   | Parcelë | 1     |
| 1.2  | Parcela prej 0.50 ha deri 1 ha   | Parcelë | 1     |
| 1.3  | Parcela prej 1 ha deri 2.5 ha  | Parcelë | 1     |
| 1.4  | Parcela prej 2.5 ha deri 5 ha  | Parcelë | 1     |
| II   | <b>Ndarja e Parcelave- Poentim 10 pikë</b>   |         |       |
| 2.1  | Krijimi I një parcele te re nga procesi I ndarjes së parcelës deri 0.50 ha           | Parcelë | 1     |
| 2.2  | Krijimi I një parcele te re nga procesi I ndarjes së parcelës prej 0.50 ha deri 1 ha | Parcelë | 1     |
| 2.3  | Krijimi I një parcele te re nga procesi I ndarjes së parcelës prej 1 ha deri 2.5 ha  | Parcelë | 1     |

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.



|            |   |         |   |
|------------|---|---------|---|
| 2.4        | Krijimi I një parcele te re nga procesi I ndarjes së parcelës prej 2.5 ha deri 5 ha | Parcelë | 1 |
| 2.5        | Krijimi I një parcele te re nga procesi I ndarjes së parcelës prej 5 ha deri 10 ha  | Parcelë | 1 |
| <b>III</b> | <b>Bashkim i parcelave - Poentim 10 pikë</b>  |         |   |
| 3.1        | Krijimi i një parcele te re nga procesi i bashkimit të dy parcelave                 | Parcelë | 1 |
| 3.2        | Për çdo parcelë tjeter në kufi  | Parcelë | 1 |
| <b>IV</b>  | <b>Ri-rregullimi i kufijve të parcelave - Poentim 10 pikë</b>                       |         |   |
| 4.1        | Për një parcelë me sipërfaqe deri 0.50 ha   | Parcelë | 1 |
| 4.2        | Për një parcelë me sipërfaqe prej 0.5 ha deri 1 ha                                  | Parcelë | 1 |
| 4.3        | Për çdo hektar tjeter mbi një hektar  | Parcelë | 1 |
| <b>V</b>   | <b>Identifikimi i njësive kadastrale - Poentim 15 pikë</b>                          |         |   |
| 5.1        | Identifikimi i njësive kadastrale në terren   | Parcelë | 1 |
| 5.2        | Identifikimi i njësive kadastrale në zyre   | Parcelë | 1 |
| <b>VI</b>  | <b>Incizimi gjeodezike i infrastrukturës - Poentim 20 pikë</b>                      |         |   |
| 6.1        | Matja e rrugëve me asfalt dhe kubeza  | m       | 1 |
| 6.2        | Matja e trasesë së kanalizimit, pusetave  | m       | 1 |
| 6.3        | Matje e trasesë se ujësjellësit, pusetave   | m       | 1 |

**1.2** Kontrata hynë në fuqi me **05.07.2023** dhe përfundon në datën **04.07.2026** ose nëse përbushet vlera e kontratës më herët se data e përcaktuar më lartë.

**1.3** Afati kohor për matjet sipas kërkesës do të jetë **dhjetë (10) ditë nga data e marrjes së kërkesës nga Autoriteti Kontraktues.**

**1.4** Vendi i performimit te shërbimeve është: **Matjet do të kryhen në zonat kadastrale në Mamushë** dhe në **kufijtë kadastral me komunat fqinje.**

#### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **10,000.00 €; Dhjetëmijë** Euro për periudhën prej 36 muajve.

2.2 Çmimi për njësi i të gjitha shërbimeve të paraqitura në përshkrimin e çmimit të tenderit është: **923.20 €. Nëntëqindjenjëzetë Euro e njëzetë Eurocent.**

2.3 Çmimi i poentuar është: **170,29 €; Njëqindeshatatëdhjetë** Euro e **njëzenëntë** Eurocent.

2.4 Çmimi i përmendur në Nenin 2.2 më sipër është çmimi i llogaritur për njësi (1) i të gjitha artikujve për shërbim dhe dorëzim. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë gjithë kohës së kontratës.

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

#### Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit te Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.



4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshtësia në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe<sup>2</sup> në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Ofruesin e Shërbimeve.

**Për Operatorin Ekonomik**

**Për Autoritetin Kontraktues**

| Emri:       | Suad Çmega  | Emri:       | Gazmend Gashi   |
|-------------|---|-------------|---|
| Pozita:     | Drejtore  | Pozita:     | Udhëheqës i sektorit të Prokurimit  |
| Nënshkrimi: |                | Nënshkrimi: |                |
| Data:       | 05.07.2023<br> | Data:       | 05.07.2023<br> |
| Vula:       |   | Vula:       |   |

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tendoruesit në këtë tender.

# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 626-23-5049-2-2-1/C140

## Neni 1 Përkuftizimet

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofroesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.
- 1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofroesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofroesit të Shërbimeve.
- 1.3 "Ofroesi i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofroesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofroesi i Shërbimeve.
- 1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofroesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofroesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofroesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:
  - a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofroesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
  - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofroesit të Shërbimeve siguruesve të Ofroesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofroesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofroesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofroesi i Shërbimeve ia

beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### **Neni 5 Tatimet dhe Doganat**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

#### **Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve**

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose ne një date tjeter të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

#### **Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit**

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyë:

- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvëçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### Neni 8                  **Forca madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjeter e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e futje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9                  **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgjegluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpërt kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

## Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

## Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitet janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

#### Neni 12            Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 13            Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zgres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

#### Neni 14            Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

#### Neni 15            Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

#### Neni 16            Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

16.2 Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalenderike nga data në të cilën kërkesa e

pranueshme pér pagesë éshtë regjistruar nga departamenti pérkatës. Data e pagesës do tē jetë data në tē cilën debitohet llogaria e institucionit. Kérkesa pér pagesë nuk do tē jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kérkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund tē pezullohet duke e lajmëruar Ofrcuesin e Shërbimeve që kérkesa pér pagesë nuk mund tē plotësohet sepse shuma nuk do tē paguhet pér shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura pérmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund tē mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund tē bëhet një inspektim i menjëhershëm pér qëllim tē kontrollimeve tjera. Ofrcuesi i Shërbimeve do tē japë sqarime, modifikime apo informata tē tjera brenda 15 ditësh pas kérkesës. Periudha e pagesës do tē llogaritet nga data në tē cilën éshtë regjistruar kérkesa pér pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që tē ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofrcuesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, tē kérkojë interesin pér pagesë tē vonuar me normë tē re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë tē muajit në tē cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë tē përqindjes. Interesi pér pagesë tē vonuar do tē zbatohet pér kohën që kalon ndërmjet datës së afatit tē fundit tē pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në tē cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i jasin tē drejtë Ofrcuesit tē Shërbimeve që ose tē mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh pér Autoritetin kontraktues.

#### **Neni 17 Kontrolli i kualitetit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit tē Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do tē jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do tē kontrollojë punën e ofrcuesit të shërbimeve dhe tē njoftojë atë pér çdo defekt që éshtë gjetur. Kontrolli i tillë nuk do tē ndikojë në përgjegjësitet e ofrcuesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund tē udhëzojë ofrcuesit e shërbimeve tē kérkojnë një defekt dhe tē zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund tē ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve éshtë si në KVK.

#### **Neni 18 Korrigjimi i defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do tē njoftojë ofrcuesit e shërbimeve pér çdo Defekt para përfundimit tē kontratës. Periudha garantuese e defekteve do tē zgjatet pér aq kohë sa Defektet tē korrigjohen.

18.2 Sa herë njoftimi pér një defekt éshtë dhënë, ofrcuesi i shërbimeve duhet tē përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofrcuesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do tē vlerësoj koston e korrigjimit tē defektit, ofrcuesi i shërbimeve do tē paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim pér mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin tē shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç éshtë cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do tē ketë tē drejtë pér këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave tē sipërpërmendura, mund tē jepen dëmshpërblime. Ato mund tē jenë:

- a) Dëme tē përgjithshme; ose
- b) Dëme tē likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave tē parapara në këtë nen do tē zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofrcuesit tē Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë tē gjitha përpjekë pér tē zgjidhur në mënyrë miqësore tē gjitha mosmarrëveshjet që mund tē ndodhin ndërmjet tyre. Sapo tē shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetërën me

shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periuðha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 21                  Zgidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### **Neni 22                  Dëmshpérblimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpérblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

## **KUSHTET E VEÇANTA**

Numri i kontratës: **626-23-5049-2-2-1/C140**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

|                                     |           |  |
|-------------------------------------|-----------|--|
| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës |           | <i>Amandamentimet / Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i><br>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të dy palëve kontraktuese. |
| Përshkrimi i nenit                  | Nr. Nenit | <b><i>Kushtet dhe detyrimet</i></b>  |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha        | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikson do të ketë gjykata përkatëse në Prishtinë.     |
|                                     | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.  |

|   |      |   |
|---|------|---|
| Siguria e ekzekutimit                             | 3.1  | Siguria e ekzekutimit është: <b>1,000.00 € për periudhën prej 37 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës.</b>  |
| <b>Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit</b>  | 4.1  | <p>Përgjegjësia e kontraktuesit është në rast të shkaktimit të dëmeve në persona, staf apo objekte për rrëth.</p> <p>Operatori Ekonomik është përgjegjës për sigurimin e punëtoreve të tij dhe do ti bartë të gjitha pasojat në rast të ndonjë lëndimi gjatë ekzekutimit të shërbimeve, gjatë transportit në objektet institucionale dhe në të gjitha vendet e matjeve.</p> |
| Cilësia e Shërbimeve                              | 5.0  | Shërbimet duhet të kenë cilësi të lartë dhe duhet ti përbahen me përpikëri specifikacionit teknik në dosje të tenderit.   |
| Inspektimi dhe testimi                            | 6.1  | <p>Menaxheri i Projektit:</p> <p>Inspektimi i matjeve duhet të bëhet nga njësia e pranimit me rastin e kryerjes së shërbimit nga kontraktuesi. Në rast të vërejtjes do të njoftohet menaxheri i projektit i cili do të caktohet me vendim nga ana e ZKA-së</p>  |
| Pagesa  | 7.1  | Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate me të cilën vërteton pjesën e përfunduar të shërbimeve sipas kontratës.   |
| Obligimet e garacionit                            | 8.1  | Operatori ekonomik do të ofrojë shërbime cilësore të cilat i përshtaten specifikimeve teknike në dosje të tenderit.   |
| Shërbimet pas shitjes                             | 9.1  | Periudha për përmirësimin e defekteve është 5 ditë pas dorëzimit të kërkesës (Vërejtjes) nga ana e Menaxherit të kontratës në rast se konstatohet që shërbimi nuk i plotëson specifikat teknike.  |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes               | 10.1 | Palët do të tentojnë që ti zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore. Sapo te shfaqet ndonjë mosmarrëveshje palët do ta njoftojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e mosmarrëveshjes dhe do ti sugjerojnë palës tjetër mbi variantin e zgjidhjes së kësaj.   |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore | 11.1 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Ekonomike në pajtim me ligjin në Kosovë.   |



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOSOVA CUMHURİYETİ  
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
MAMUŞA BELEDİYESİ - KOMUNA E MAMUSHËS  
OPŞTINA MAMUŞA - MUNICIPALITY OF MAMUSA



PËRSHKRIMI I ÇIMITIT

Nr. i Prokurimit / 626-23-991-2-2-1

Nr. i Brendshëm / 626-23-002-2-2-1

MATJET KATASTRALE NË MAMUSHË

| A.  | Perkufizimi i parcelave -35%  | Njësia         | Sasia   | Çmimi për njësi<br>ME TVSH € | Çmimi merr 35% të pikëve të<br>vlerësimit |
|-----|---|----------------|---------|------------------------------|---|
| 1.1 | Parcela deri 0.50 ha  | m <sup>2</sup> | 1       | 0.03                         | 0.01                                      |
| 1.2 | Parcela prej 0.50 ha deri 1 ha  | m <sup>2</sup> | 1       | 0.02                         | 0.01                                      |
|     |   |                | Totali: | 0.05                         | 0.02                                      |
| B.  | Ndarja e Parcelave  | Njësia         | Sasia   | Çmimi për njësi<br>ME TVSH € | Çmimi merr 10% të pikëve të<br>vlerësimit |
| 2.1 | Krijimi i një parcele te re nga procesi i ndarjes së parcelës deri<br>0.50 ha           | m <sup>2</sup> | 1       | 0.05                         | 0.01                                      |
| 2.2 | Krijimi i një parcele te re nga procesi i ndarjes së parcelës prej<br>0.50 ha deri 1 ha | m <sup>2</sup> | 1       | 0.05                         | 0.01                                      |
|     |   |                | Totali: | 0.10                         | 0.01                                      |
| C.  | Bashkim I parcelave   | Njësia         | Sasia   | Çmimi për njësi<br>ME TVSH € | Çmimi merr 10% të pikëve të<br>vlerësimit |
| 3.1 | Krijimi i një parcele te re nga procesi i bashkimit të dy parcelave                     | m <sup>2</sup> | 1       | 0.05                         | 0.01                                      |
| 3.2 | Për qdo parcelë tjetër në kufi  | m <sup>2</sup> | 1       | 0.05                         | 0.01                                      |
|     |   |                | Totali: | 0.10                         | 0.01                                      |
| D.  | Ri-regullimi I kufijve të parcelave   | Njësia         | Sasia   | Çmimi për njësi<br>ME TVSH € | Çmimi merr 10% të pikëve të<br>vlerësimit |
| 4.1 | Për një parcelë me sipërfaqe deri 0.50 ha   | m <sup>2</sup> | 1       | 0.05                         | 0.01                                      |
| 4.2 | Për një parcelë me sipërfaqe prej 0.5 ha deri 1 ha                                      | m <sup>2</sup> | 1       | 0.05                         | 0.01                                      |
| 4.3 | Për qdo hektar tjetër mbi një hektar  | m <sup>2</sup> | 1       | 0.05                         | 0.01                                      |
|     |   |                | Totali: | 0.15                         | 0.02                                      |
| E.  | Identifikimi i njësive kadastrale   | Njësia         | Sasia   | Çmimi për njësi<br>ME TVSH € | Çmimi merr 15% të pikëve të<br>vlerësimit |
| 5.1 | Identifikimi i njësive kadastrale në terren   | m <sup>2</sup> | 1       | 0.04                         | 0.01                                      |
| 5.2 | Identifikimi i njësive kadastrale në zyre   | m <sup>2</sup> | 1       | 0.04                         | 0.01                                      |
|     |   |                | Totali: | 0.08                         | 0.01                                      |
| F.  | Inqizimi gjeodezike I infrastrukturës   | Njësia         | Sasia   | Çmimi për njësi<br>ME TVSH € | Çmimi merr 20% të pikëve të<br>vlerësimit |
| 6.1 | Matja e rrugëve me asfalt dhe kubëza  | m              | 1       | 0.15                         | 0.03                                      |
| 6.2 | Matja e trases kanalizimit, pusetave  | m              | 1       | 0.15                         | 0.03                                      |
| 6.3 | Matje e trases se ujsjellesit, pusetave   | m              | 1       | 0.15                         | 0.03                                      |
|     |   |                | Totali: | 0.45                         | 0.09                                      |

REKAPITULLIM

|  |   | ÇMIMI TOTAL | ÇMIMI TOTAL I POENTUAR |
|--|---|-------------|------------------------|
| A  | Perkufizimi i parcelave (35%)               | € 0.05      | € 0.02                 |
| B  | Ndarja e Parcelave (10%)                    | € 0.10      | € 0.01                 |
| C  | Bashkim I parcelave ( 10%)                  | € 0.10      | € 0.01                 |
| D  | Ri-regullimi I kufijve të parcelave ( 10%)  | € 0.15      | € 0.02                 |
| E  | Identifikimi i njësive kadastrale ( 15%)    | € 0.08      | € 0.01                 |
| F  | Inqizimi gjeodezike I infrastrukturës (20%) | € 0.45      | € 0.09                 |
| Çmimi i Pergjithshem i peshuar (ofertat do te vleresohej ne baze te kesaj vlore). Kjo është vlera e cila duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhë do te lexohet gjatë hapjes publike. |   |             | € 0.15                 |

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK

|                            |                    |
|----------------------------|--------------------|
| EMRI I OPERATORIT EKONOMIK | GJEOPROJEKT SH.P.K |
| ADRESA E PLOTE             | Rr.UÇK-pn,Rahovec  |
| PERFAQESUAR NGA:           |                    |
| EMRI & MBIEMRI             | Suad Çmëga         |
| POZITA                     | Drejtësor          |
| NËNSHKRIMI                 | 15.03.2023         |
| DATA                       |                    |
| VULA                       |                    |




**Dega** GJAKOVË

**Numri i polices** 060040060091723

**1 Të dhënat për agjentin - Agent details**

| Emri dhe mbiemri   | Adresa                       | Nr. i tel   | Nr. ID |
|--------------------|------------------------------|-------------|--------|
| Murat Morina-01905 | Rr.Xhelal Hajda p.n, Rahovec | 044 500 041 | 004006 |

**2 SIGURUESI / Garantuesi: Kompania e Sigurimit " SIGKOS " sh.a., Prishtinë**

|                    |                       |                |           |
|--------------------|-----------------------|----------------|-----------|
| I SIGURUARI        | GJEOPROJEKT SH.P.K.   |                |           |
| Adresa             | RR.UÇK-SE PN. Rahovec |                |           |
| Përfaqësuar nga Z. | SUAD ÇMEGA            | Nr. i biznesit | 810734451 |

**3 Siguruesi dhe i siguruari me vullnet të lirë , të barabartë dhe me mirëbesim lidhin këtë lloj sigurimi.**
**Përshkrimi i mbulesës siguruese / Garancisë - Lloji: SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT**

Titulli; Sherbime per matjet kadastrale ne Mamush-Ritender Nr Prok; 626-23-5049-2-2-1  
 Nr Bren: 626-23-002-2-2-1

a) Sigurimi i tenderit, Ekzekutimi i tenderit, Sigurim tjetër ) b) Titulli i mbulesës siguruese, c) Numri i prokurimit, etj.

|                    |  |
|--------------------|--|
| Përfituesi         | Komuna e Mamushës  |
| Adresa             | Rruja "Sahat Kulesi" nr. 44 Ndërtesa e Komunës së Mamushës |
| Shuma e siguruar € | 1,000.00 €   |

**4 LËNDA E GARANCISË: Detyrimet e Palëve sipas kësaj Police të Sigurimit janë:**

- Mbështetur në këtë Policë- Garancie, Siguruesi/Garantuesi merrë përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me ketë Policë.
- Efekti veprues i kësaj Police - Garancie, që do të thot fillimi i detyrimit të Siguruesit / Garantuesit fillon mbas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar në marrëveshjet dhe/ose kontratat e lidhura në mes te të Siguruarit/Kontraktuesit dhe Përfituesit që sjellin detyrimet kontrakte për kontraktuesin, që do të thot se Përfituesi nuk mund të paraqes kërkesa në zbatim të kësaj Police kur Kontraktuesi është brenda afatit përmbrashjen detyrimeve të tij ndaj Përfituesit sipas disponitave në fuqi.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit/Garantuesit përmarrjen e dëmshpërbimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen përfaj te të Siguruarit/ Kontraktuesit - Ekzekutesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Perfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, përf t'berë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj Perfituesit (cedimi i të drejtave nga Perfituesi tek Siguruesi / Garantuesi)

**Periudha e sigurimit/garancisë**
**Fillon me:** 05.07.2023

**Mbaron me:** 03.08.2026

**5**

| Shuma e siguruar | Primi neto € | TVSH    | Primi total € |
|------------------|--------------|---------|---------------|
| 1,000.00 €       | 154.16 €     | 27.75 € | 181.91 €      |

Ky Sigurim është lidhur sipas Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit të Garancive të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.

**Primi i sigurimit paguhet törësisht**  
 Premium is paid completely

181.91 €

**Datë**  
 Data 05.07.2023

**Me këste: Numri i këstevë**  
 In Instalments:Nr. of Inst.

**Shënimë tjera:**
**I Siguruar / The Insured**

SUAD ÇMEGA

**Data e lëshimit / Issued date**

05.07.2023

**Siguruesi / The Insurer**

Murat Morina-01905





## SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **Komuna e Mamushës**  
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **GJEOPROJEKT SH.P.K. , RR.UÇK-SE PN. Rahovec**  
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: Titulli; Sherbime per matjet kadastrale ne Mamush-Ritender  
Nr Prok; 626-23-5049-2-2-1  
Nr Bren: 626-23-002-2-2-1

### Garacion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;


ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Nje mijë 1,000.00 €** zotohemë të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **1,000.00 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **1125** ditë prej **05.07.2023** deri më **03.08.2026**

Garacioni në fjalë skadon tërësisht dhe në menyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.

  
Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit finanziar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.  
Lagjja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistralja  
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë

